

LIGJ
Nr.9387, datë 4.5.2005

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8461, DATË 25.2.1999 “PËR
ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në paragrafin e dytë të nenit 2, pas shprehjes “të përgatisë e të kualifikojë oficerë dhe specialistë të lartë” shtohet shprehja “si edhe shkencëtarë të rinj”.

Neni 2

Në nenin 8 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Titullari i universitetit ushtarak emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, nga radhët e oficerëve madhorë ose të civilëve, me titull a gradë shkencore, ndërsa titullari i Akademisë së Policisë emërohet në përputhje me ligjin nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.”.

2. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Universiteti ushtarak është institucion arsimor në varësi të strukturave hierarkike të Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa Akademia e Policisë është institucion arsimor në varësi të strukturave hierarkike të Ministrisë së Rendit Publik.”.

Neni 3

Paragrafi i tretë i nenit 15 shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 16 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, pas fjalës “të larta” shtohen fjalët “civile e ushtarake”.
2. Në shkronjën “d” hiqen fjalët “ushtarake ose”.

Neni 5

Në nenin 32 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në paragrafin e fundit të nenit 32 fjalia “Studentët pajisen me kartën e studentit” ndryshohet si më poshtë:

“Studentët pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik, që përdoret nga të gjithë studentët e arsimit të lartë publik e jopublik me kohë të plotë, me anë të së cilës studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara. Organi përgjegjës për lëshimin e këtij dokumenti është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Karta e studentit ka të njëjtat parametra për të gjitha universitetet në Republikën e Shqipërisë. Çmimi, forma, përmbajtja, elementet e sigurisë dhe procedurat për pajisjen

me kartën e studentit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

2. Në fund të këtij neni shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit përcaktohen:

a) me vendim të Këshillit të Ministrave për tarifat e reduktuara të shërbimeve, që ofrojnë entet publike;

b) me marrëveshjet e organizmave që kanë objekt të tyre interesat studentorë me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme.”.

Neni 6

Në nenin 40 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik kryejnë kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në shkollat e larta përkatëse.”.

2. Në paragrafin e dytë pas fjalës “shkencës” shtohen emërtesat “Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik.”.

3. Në paragrafin e fundit, pas fjalëve “dhe Shkencës” shtohen fjalët “Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Rendit Publik.”.

Neni 7

Ngarkohet Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji, të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave projektvendimin për kartën e studentit, në zbatim të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4593, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**